 - **Magazinë ushqimore** në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale, e përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuar të pajisur me leje Higjieno-Sanitare, tekniko teknologjike si dhe Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL).
 - **Njësi për produktin mish (ambiente frigoriferike)** në pronësi/përdorim sipas kontratës noteriale të pajisur me: leje higjieno-sanitare, liçensë lëshuar nga QKL,. Për produktin e mësipërm në rastin kur operatori nuk e ka njësi në pronësi apo përdorim, duhet të paraqes kontratë noteriale me firmën që të vërtetojë bashkëpunimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: liçensë, numër telefoni, e-mail, website etj. e nevojshme kjo për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.
 - **Njësi prodhimi bulmeti** në pronësi/përdorim sipas kontratës noteriale të pajisur me: leje higjieno-sanitare, liçensë lëshuar nga QKL. Për produktin e mësipërm në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi apo përdorim duhet të paraqes kontratë noteriale me firmën që të vërtetojë bashkëpunimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: liçensë, numër telefoni, e-mail, website etj. e nevojshme kjo për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi..
 - **Për artikullin vezë**, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë furnizimi me shoqëri prodhuese të produktit. Leja higjieno- sanitare dhe liçensa nga QKL.
8. Numri mesatar i punonjesve për **gjashtë mujori e fundit** duhet të jete jo më pak se 5 punonjes keto të pajisur me librezat shëndetësore të shoqëruar me listpagesat për **gjashtë mujorin e fundit**.

9. Operatori ekonomik pjesmarres ne tenderin e mesiperm duhet te ushtroje aktivitetin e tyre ne qytetin ku ndodhet institucioni prokurues. (ose te kete pike kontakti ne qytet te vertetuar me dokumentacion perkates ligjore i regjistruar ne QKB).

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.



Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

ARTIKULLI: SHEQER

Treguesit shqisorë:

- **Pamja e jashtme:** Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa lëndë të huaja, i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.
- **Ngjyra:** e bardhë dhe me shkëlqim.
- **Shija dhe era:** Shije e ëmbël, pa shije dhe erë të huaj kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.
- **Tretshmëria:** Të tretet plotësisht në ujë, tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shtetëror 1413-87.

- Sheqer i pastër i llogaritur me lëndë absolutisht të thata jo më pak se 99,6%.
- Lëndë reduktuese (sheqer invert) jo më shumë se 0,1%.
- Lagështia jo më shumë se 0,16%.
- Hiri jo më shumë se 0,07%.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Të jetë me paketim 1 kg neto. Mbi çdo paketim të jetë e përcaktuar: Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1 vit nga data e furnizimit në institucion.

Mjeti që e transporton duhet të jetë i mbyllur dhe i caktuar vetëm për produkte ushqimore.

ARTIKULLI ORIZ

Treguesit shqisorë.

- **Pamja e jashtme:** Kokrra të shëndosha, të pastra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije dhe erë myku ose prishje.
- **Ngjyra:** E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.
- **Era dhe shija:** Karakteristike e orizit të shëndoshë, pa shije të thartë, të hidhur, pa erë të mykur dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standardit Shtetëror 1738-87.

- Lagështia jo më shumë se 15%.
- Lëndë të huaja jo më shumë se 0,4%.
- Kokrra të thyera më të vogla se gjysma jo më shumë se 12%.
- Lëndë minerale nuk lejohen.
- Kokrra të verdha jo më shumë se 4 %.

- Kokrra të pazhvilluara, jeshile, të pazhveshura nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Në letër ambalazhi të pastër ose polietileni me masë 1 kg. Afati i skadences të jetë jo më pak se 1 vjet nga data e furnizimit në institucion.

Mjeti që e transporton duhet të jetë i mbyllur dhe i caktuar vetëm për produkte ushqimore.

ARTIKULLI: MAKARONA

Treguesit shqisorë.

- **Forma:** Makarona spageti me gjatësi jo më të vogël se 30 cm, me trashësi deri 2,4 mm.
- **Pamja e jashtme:** Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër. Pas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.
- **Ngjyra:** E bardhë me nuancë të verdhë, ne thyerje qelqore me jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.
- **Era dhe shija:** E mirë karakteristike e makaronave pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe pa çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standardit Shtetëror 1170-87.

- Lagështia jo më shumë se 13%.
- Aciditeti: Acid sulfurik jo më shumë se 0,16%.
- Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 herë.
- Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

- Në letër ambalazhi të pastër ose polietileni me masë 500 gr ose 1 kg të futura në kuti kartoni deri në 20 kg. Në çdo pako shmangie në masë deri + - 2%.
- Në ambalazh të jetë shënuar dhe afati i skadencës. Afati i skadences të jetë jo më pak se 1 vit nga data e furnizimit në institucion.

MAKARONA SUPE

Te jene me ngjyre te bardhe ne te verdhe, pa shije te hidhur e te tharte, pa ere te huaj. Ambalazhi ne pako 0.5 kg, letre ose plastmasi. Ne ambalazh te jene te shenuara data e prodhimit dhe ajo e skadences si dhe permbajtja ne gjuhen shqip

ARTIKULLI: VAJ LULE DIELLI

Treguesit shqisorë.

- **Pamja në 20⁰ C:** Lëng vajor, i qartë, pa depozitime.
- **Ngjyra:** E verdhë e lehtë.
- **Eradhe shija:** E mirë karakteristike e vajit lule dielli, pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.
- **Përmbajtja e acideve yndyrore** sipas S SH 203:2003.

Treguesit fiziko – kimikë.

- Dendësia relative në (20⁰ C/ujë në 20⁰ C) 0,918-0,923.
- Treguesi i refrakcionit =1,461-1,468.
- Numri i sapunifikimit (mg KOH/gr vaj) 188-194.
- Treguesi i jodit 118-141.
- Lëndë të pasapunifikueshme: ≤ 15 gr/kg.
- Lëndët fluturuese në 105 gradë Cjo më shumë se 0.2%.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Vaj lule dielli i rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 litër, të mbyllura me tapë plastike me vidhëzim hermetik të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse. Shmangia nga vëllimi është deri +/- 1%.

Etiketimi bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën do të shënohet:

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1 vjet nga data e furnizimit në institucion.

Shishet do të ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mirë ose me material tjetër të përshtatshëm.

ARTIKULLI: REQEL

Reçeli të jetë e prodhuar nga frutat me bazë molle ose fiku ose kumbulle ose qershie.

Të jetë i sterilizuar dhe i cilësisë së parë.

Të ketë erë të pëlqyeshme, karakteristike e frytit që mbizotëron, e ëmbël pa shije fermentimi, sipërfaqja jo e ngjitshme, jo e sheqerosur, të jetë elastike dhe e shndritshme, të mos ketë shenja myku, të ketë ngjyre të çelur.

Treguesit fiziko-kimikë dhe ambalazhimi të jenë sipas STASH 1416-87 për marmalatën dhe sipas STASH 1477-87 për reçelin.

ARTIKULLI: SALCË DOMATESH

Kërkohet salcë domate e ambalazhuar në kuti llamarine ose shishe qelqi.

Kutia të jetë e mbyllur hermetikisht dhe e mbështjellë me etiketë të përkthyer në gjuhën shqipe kur malli është i huaj.

Përmbajtja të jetë salcë dhe kripë.

Përbërja e lëndës së thatë të jetë 20 % + 1.

Nuk lejohen përbërës të tjerë dhe lëndë të huaja.

Ngjyra e salcës të jetë e kuqe e thellë.

Shija të jetë karakteristike e salcës së domates pa shume aciditet.

Aroma të jetë e këndshme në përputhje me aromën e domates së freskët karakteristike e llojit.

Në etiketë të jetë shënuar qartë firma prodhuese, data e prodhimit dhe përdorimit.

Treguesit fiziko-kimikë dhe ambalazhimi të jenë sipas STASH 1429-87.

ARTIKULLI: KRIPË USHQIMORE

Të jetë e cilësisë së parë, e ambalazhuar në pako 0.5 deri 1 kg.

Pamja: masë kokrrizore me ngjyrë të bardhë.

Me shije karakteristike të kripur, pa shije dhe erë të huaj, e tretshme plotësisht në ujë.

Në ambalazh vendoset etiketa ku shënohet lloji i kripës, origjina e mallit.

Ruhet në vende të pastra dhe të mbrojtura nga lagështira e lëndët kimike.

LLOJI I MALLIT: PERIME E ZARZAVATE

PATATE.

Kërkohet cilësia e parë, të jetë e plotë, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipike të kultivarit.

Kokrra të jetë e pjekur.

Madhësia e kokrrës për të rrumbullakëtat të jetë për pataten dimërore mbi 5 cm dhe për ato verore mbi 4 cm, për vezaket për dimëroret dhe veroret 4 cm.

Nuk lejohen të çara e të prera, të kalbura, njolla boje hiri e ndryshku, dëmtime nga dosa dhe të pa pastruara nga dherat.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1729-88.

Duhet të jenë të ambalazuara në thasë rrjete 25 deri në 30 kg.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin 1799\88.

QEPË E THATË

Kërkohet cilësia e parë, të jetë me pjekuri të plotë, me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota, me ngjyrë e forme tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.

Madhësia e kokrrës për ovalet të jetë nga 4 deri në 5 cm.

Lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja.

Me sëmundje nuk lejohen.

Të ngrira, të kalbura e të mykura nuk lejohen.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1755-88

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin 1799\88.

DOMATE

Kërkohet domate e cilësisë së parë, ku të jenë të freskëta, me formë tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pa vrara, të pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga djegia e diellit, të pa prekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të pa lagura.

Pjekuria duhet të jetë normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit.

Nuk lejohen domate të tejpekura, të zbutura e të vyshkura.

Dëmtime e sëmundje nuk lejohen.

Të plasura e të vrara lehtësisht për llojet e mesme e të vona lejohet deri në 5 % plasaritje rreth bishtit, por pa rrjedhje lëngu.

Madhësia e kokrrës të jetë jo më pak se:

Për të hershmet 5 cm.

Për të mesmet e të vonat 7 cm.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1726-88

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin 1799\88.

PRESHI

Kërkohet cilësia e parë, të jetë i freskët, i njomë, i pastër, me ngjyrë të bardhë e jeshile, i pa vyshkur dhe i larë me ujë të pijshëm.

Diametri në pjesën më të trashë të jetë mbi 2.5-3.5 cm.

Gjatësia e kërcellit të jetë 25-45 cm.

Gjatësia e gjethit nga rozeta të jetë jo më shumë se 20 cm.

Sistemi rrënjor të jetë jo më shumë se 1 cm.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1759-88.

Dëmtime e sëmundje nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar në standartin 1799\88.

KARROTA

Kërkohet e cilësisë së parë të pa deformuara dhe me ngjyrën karakteristike të kultivarit. Gjatësia jo më pak se 10 cm, nuk lejohen kalbëzime, ndryshk nuk duhet të ketë njolla me ngjyrë jeshile pasi janë shkaktare të aciditetit dhe sëmundjeve.

Të thata dhe të zverdhura nuk lejohen.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1712-88

LAKRA

Kërkohet cilësia e parë, të jenë të zhvilluara, me mbështjellje fletësh, e fortë në prekje. Lejohen lakra të pa ngjeshura deri në 5 % te partisë.

Të jenë të pastra dhe me 2-3 gjethë të gjelbra, të lidhura me koçanin i cili të jetë deri në 3 cm.

Lejohen deri në 5% e partisë me dëmtime të lehta mekanike, të çara lehtësisht e të shpërthyer si dhe të dëmtuara lehtësisht nga bryma.

Me sëmundje nuk lejohen.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1758-88.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

SPINAQ

Kërkohet cilësi e parë, i freskët , i njomë, i pastër me ngjyrë jeshile të errët, i pa vyshkur dhe i larë me ujë të pastër, i lidhur në dengje të vogla deri në një kg.

Me rrënjë të prera.

Të mos ketë prani të barërave të tjera.

Gjethet të jenë pa njolla të ngjyrës së ndryshkut, pa dëmtime nga krimbat, pa dëmtime mekanike, të freskëta dhe të pavyshkuara.

SPECA - Bazuar në STASH 1756\88

Treguesit cilësorë të specës:

1. Pamja e jashtme:

Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, të freskta, të pastra dhe me pjekuri teknike.

1. Dëmtime:

Të shtypura, të gervishtura jo më shumë se 3 %


2. Shija:

Karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegëse e lehtë. Nuk lejohet përzierje e specave djegës me ato jo djegës

3. Gjatësia:

Për të gjatat mbi 10 cm.

Për të rrumbullaktat mbi 7 cm.



LLOJI I MALLIT: FRUTA

(mollë, portokalle,)

1. MOLLA:

Bazuar në STASH 1752-88

Kërkohet cilësia e parë, me formë,ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike të njëjtë, të shëndosha, të pastra, të zhvilluara normalisht, pa erë e shije të huaja.

Lejohen edhe kokrra pa bisht, por pa defekte rreth bishtit.

Dëmtime të ndryshme mekanike lejohen deri në dy njolla jo të zeza, të vogla, të lehta për kokërr.

Nuk lejohen të krimbura.

Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë nuk lejohen.

Gunga në lëkurë nuk lejohen. Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës nuk lejohen

më tepër se deri në $\frac{1}{4}$ e sipërfaqes së frutit.

2. PORTOKALLI:

Bazuar në STASH 1722-88

Kërkohet cilësi e parë, i freskët, me zhvillim normal, të shëndoshë e me bisht. Pas 15 janarit lejohet kokrra pa bisht, përkatësisht 5 & 20 %, me pjekuri teknike të plotë.

Ngjyra të jetë karakteristike e kultivarit, e verdhë në portokalli, me erë karakteristike dhe shije të ëmbël, pa shije të hidhur.

Dëmtime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen.

Lëndë të huaja nuk lejohen.

Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagie të sipërfaqes nuk lejohen.

Ambalazhimi të jetë me kuti kartoni në brendësi të mbështjelle me letër celofoni standarte 10, ose 20 kg.

Në etiketë të jetë shënuar data e prodhimit dhe data e skadencës si dhe origjina e prodhimit të mallit.

LLOJI I MALLIT:DJATHË I BARDHË,GJALPË I FRESKËT

DJATHË I BARDHË

Kërkohet cilësia e parë, vendi, me bazë prodhim djathin/produkt i qumështit të lopës, deles, ose dhisë sipas STASH 1410-87.

Nuk lejohet prodhim i djathit me përzierje qumësht pluhur ose të kondensuar.

Djathi të ketë kaluar periudhën e stazhionimit sipas standardeve shtetërore.

Ngjyra të jetë sipas llojit të qumështit, djathë lope, i deles dhe dhisë të ketë ngjyrën karakteristike të qumështit.(i bardhë kur djathi është prodhuar me bazë qumështi deleje ose dhie dhe ngjyrë kremi kur djathi është prodhuar nga qumështi i lopës).

Pamja e jashtme të jetë konforme, në brendësi poroze karakteristike e djathit të stazhionuar mirë.

Sasia e kripës të jetë normale sipas standardit.

Shija të jetë e mirë karakteristike e djathit normal pa erëra të tjera jo të këndshme.

Përmbajtja mikrobiale të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Treguesit fiziko-kimikë të jenë sipas STASH 1410-87.

Ambalazhimi të jetë në fuçi ose voza deri në 20 kg i shoqëruar me shëllirë, mbi të cilën vendoset etiketa ku të jetë shënuar: lloji i djathit sipas standardit në fuqi, origjina e prodhimit të mallit, masa bruto ose neto dhe data e prodhimit. Në rast të qëndrimit në institucion më shumë se dy javë, djathit të vendosur në fuçi t'i ndërrohet shëllira dhe ky shpenzim të përballohet nga operatori ekonomik i cili do të shpallet fitues.

Malli të jetë i shoqëruar me certifikatë të cilësisë për çdo parti prodhimi

Prodhimi të jetë i shoqëruar me fletë analizë laboratorike.

Në fletë analizat ose certifikatat e cilësisë, firmat fituese të tenderit të shënojnë sasinë e

prodhimit që i referohet kjo fletë analizë

GJALPË I FRESKËT

Të jetë prodhim me bazë qumësht lope, deleje ose dhie, ose përzierje e tyre sipas STASH 1445-87.

Ngjyra të jetë e verdhë karakteristike e gjalpës ose e bardhë karakteristike e gjalpës të dhisë dhe deles.

Nuk lejohen përbërës të tjerë, njolla të errëta karakteristike e gjalpës jo të freskët.

Shija të jetë e këndshme, pa erëra të tjera jo natyrale.

Ambalazhimi të jetë me kuti kartoni dhe në voza, me masë 5 dhe 25 kg dhe me masë 50-100 kg si dhe me letër celofan ose oleate me masë 100, 200 dhe 500 gram.

Mbi ambalazhim të vendoset etiketa ku të jetë shënuar data e prodhimit, masa bruto ose neto si dhe origjina e prodhimit.

Prodhimi të jetë i shoqëruar me fletë analizë laboratorike.

Në fletë analizat ose certifikatat e cilësisë, firmat fituese të tenderit të shënojnë sasinë e prodhimit që i referohet kjo fletë analizë.

QUMËSHT I FRESKËT

Treguesit shqisorë: Qumështi të jetë pa përbërje uji dhe përbërësish të tjerë të dëmshëm, i freskët, të jetë qumësht lope, i cilësisë së parë, pa mbeturina.

Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Ambalazhimi: Do të jetë i pakëtuar me kuti 1 liter (një liter) me përqindje yndyre 2.8%

Prodhimi për çdo furnizim të jetë i shoqëruar me certifikate të analizës.

Në fletë analizat ose certifikatat e cilësisë, firmat fituese të tenderit të shënojnë sasinë e prodhimit që i referohet kjo fletë analizë.

LLOJI I MALLIT: VEZË

VEZË

Bazuar në STASH 1515-85

Sipas Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

Të jenë me peshë 63 deri 73 gr për /kokërr.

Të jenë të pastra, të thata, pa aroma të pakëndshme, të mbrojtura efektivisht nga tronditjet dhe nga kontakti i drejtpërdrejtë me diellin, sipas kërkesave specifike të higjienës bazuar në Udhëzimin Nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Të jenë të vendosura në bikurina, të ambalazhuara në kuti kartoni ose arka. Shenjat për numrin e dallueshëm të prodhuesit, datës së skadencës të jenë mbi vezë ose mbi ambalazhin e tyre, ose

mbi të dyja, ose në vende të dukshme të tyre sipas rregullores së sipërpërmendur.

LLOJI I MALLIT:BUKË GRURI

BUKË GRURI

Specifikimet teknike: të plotësojnë kërkesat e standartit shtetëror Nr 1411, te vitit 1987.

Pesha e bukës **1000 gram**. Lejohen mënjanimet + - 3 % për çdo bukë.

Buka e grurit do të prodhohet me miell që të jetë i freskët, me ngjyrë, erë, shije dhe lagështirë komform standardeve përkatëse. Mielli nuk duhet të ketë asnjë lloj lënde të huaj.

Buka duhet të ketë formë të drejtë dhe normale, pa deformime dhe sipërfaqja e bukës duhet të jetë e lëmuar dhe pa plasje të ndryshme. Vëllimi i bukës duhet të jetë i mjaftueshëm. Shija, era, lagështira dhe aciditeti i bukës duhet të jetë konform standardit teknik të prodhimit të saj.

Korja e bukës duhet të jetë e lëmuar, pa djegie, pa shkëputje të saj nga tuli, ngjyra e njëllotë, mjalti në të kuqërremte në të gjithë sipërfaqen.

Tuli duhet të jetë i pjekur mirë, me porozitet të imët në të gjithë vëllimin e tij dhe nuk duhet të ketë gjurmë mielli të pabrumosura.

Nuk pranohet bukë e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me erë të huaj, me shije të hidhur e të thartë, me lëndë të huaja, me lagështirë jo normale, me shije myku.

Buka preferohet në formë katërkëndëshe.

Treguesit fiziko-kimikë:

Lagështira, poroziteti, aciditeti, kripa, të jenë sipas STASH 1411-87.

Buka të jetë e prodhuar brenda ditës. Furnizimi i bukës do të bëhet jo më pak se 4 orë pas pjekjes. **Ambalazhimi i bukës të bëhet sipas Udhëzimit Nr.15, datë 13.12.2012 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit“Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”.**

LLOJI I MALLIT: MIELL GRURI

MIELL GRURI

Bazuar ne STASH 1455\87

Ngjyra e bardhë me nuance të lehtë në të verdhe ne varesi të llojit të grurit.

Pjesezat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.

Pa ere myku, pa shije të hidhur, të tharta dhe pa ere ë e shije të huaj. Nuk lejohen kercitje.

Lageshtira ,%, jo me shume se 14.

Aciditeti i shprehur ne acid sulfurik ne lendet absolutisht të thata ,%,jo me shume se 0.115

-Lende minerale .Nuk lejohen .

-Perzierje metalike.Plumbi,zinku e bakri nuk lejohen .Lejohet permbajtja e hekurit ne forme thermijash nen 0.3 mm, jo me shume se 3mg.g

-Mikroorganizma patogjene,infestime dhe demtues hambari të gjalle. Nuk lejohen .

Ambalazhimi bëhet në thasë polietileni të pastër të qepur në grykë me masë 25-50kg. Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shënohen të dhenat e mëposhtme:

Enti prodhuese.

Lloji i miellit.

Data e prodhimit dhe data e skadimit .

e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitre per transportimin e produkteve ushqimore.

MIELL ORIZI

Ngjyra:E bardhe me nuance ngjyre te verdhe Era dhe shija: Karakteristike e miellit te orizit,pa shije te tharet e te hidhur,pa ere te mykur dhe ere tjeter te huaj. Treguesit fiziko- kimike: Lageshtia:12.8% Aciditeti 0.081% Lende te huaja jo me shume se 0.2% Lende minerale nuk lejohen. Ambalazhimi i paketuar ne qese letre me peshe 0.5kg.-1kg. Marketimi: Emertimi i prodhuesit Emertimi i produktit. Pesha neto Data e skadimit Kushtet e vecanta te ruajtjes Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit

NISESHTE

Të jetë e cilësisë së parë, e stazhionuar, e ambalazhuar në pako 1 kg letre, ku të shënohet:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

LLOJI I MALLIT:MISH

3. MISH VIÇI I FRESKËT

Specifikimet teknike.

Kërkohet mish viçi në rritje me cilësi që të plotësojë kërkesat e standardit shtetëror Nr 1441, të vitit 1987.

Pamja e jashtme :

- Sipërfaqja e jashtme të jetë e mbuluar me një cipë të hollë tharje.
- Sipërfaqja e mishit të ftohur menjëherë pas prerjes të jetë i tejdukshëm.
- Tendinat të jenë të ndritshme, elastike dhe të forta.

Ngjyra: Mishi të jetë me ngjyrë rozë dhe i dhjavit të jetë me ngjyrë të bardhë.

Konsistenca: Të jetë e butë dhe elastike. Në prerje të duket kompakt.

Era: Të jetë e këndshme, karakteristike e llojit.

a).Pjesa e karkases (shpatull,kofshe,dhe gjoks) duhet te jete e vulosur me vulen e kontrollit vetrinare .

b). Cdo parti /karkase duhet te shoqerohet me certifikat vetrinare,e cila garanton sigurin e produktit ‘mish” dhe me te cilen vertetohet se ,nga kontrolli i kryer nuk eshte prekur nga semundje,por qe eshte i sigurt dhe se lejohet te tregtohet per konsum publik.

Transporti i mishit do të bëhet me mjetet e subjektit fitues të tenderit (mjeti të jetë i përshtatshëm për transport mishi, mjet frigoriferik).

Për të gjithë artikujt ushqimorë do të zbatohen dispozitat e përgjithshme të Ligjit për Ushqimin Nr. 9863 datë 28.1.2008.

Firma fituese do ta shoqërojë mallin me certifikatën e origjinës dhe fletë analizë për treguesit fiziko-kimikë.

Të gjitha shpenzimet laboratorike për analizat e treguesve cilësorë që do të bëjnë institucionet e përkujdesit për artikujt e lartpërmendur, do të përballohen nga firma fituese

Transporti i mallit, deri në magazinat përkatëse të çdo institucioni përkujdesi do të përballohet me mjetet e subjektit që do të shpallet fitues i tenderit.

Në fletë analizat ose certifikatat e cilësisë, firma fituese e tenderit të shënojnë sasinë e prodhimit që i referohet kjo fletë analizë.

Operatori ekonomik, i cili do të shpallet fitues, para lidhjes së kontratës, ka detyrim të paraqesë dokumentacion provues, ku të tregohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet, konform kërkesave ligjore.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Sipas kërkesave të mesiperme.**

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]



PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Mall:		Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT



Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi	Njesia	SASIA	Cmimi pa tvsh	Vlera
1	Oriz	kg	1400		
2	Makarona	kg	1000		
3	Buke	kg	13800		
4	Vaj	lit	2200		
5	Makarona Supe	kg	300		
6	Sheqer	kg	280		
7	Qumesht i Fresket	lit	15640		
8	Mish Vici	kg	4200		
9	Patate	kg	10000		
10	Djathe i Bardhe	kg	2800		
11	Veze	kokerr	70000		
12	Kripe	kg	100		
13	Miell Gruri	kg	50		
14	Miell Orizi	kg	25		
15	Recel	kg	100		
16	Salce	kg	500		
17	Qepe	kg	700		

Dokumentat Standarde të Tenderit

18	Karrota	kg	100		
19	Domate	kg	100		
20	Speca	kg	97		
21	Niseshte	kg	10		
22	Lakra	kg	500		
23	Purrinj	kg	500		
24	Spinak	kg	1000		
25	Molla	kg	150		
26	Portokalla	kg	150		
27	Gjalpe	kg	10		
	Vlera pa tvsh				8,883,208.00

Afatet e lëvrimit: Duke filluar nga nënshkrimi i kontratës deri në 12 muaj dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.



Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]



I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të

LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Public Health Sector

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrime” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi,

kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intellektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikatat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

